


Bibël për fëmijët
paraqet

Dyzet
Vjet




Shkruar nga: Edward Hughes
Ilustruar nga: Janie Forest
Adaptuar nga: Lyn Doerksen
Përkthyer nga: Arianit Iljazi
Prodhuar nga: Bible for Children
www.M1914.org

BFC
PO Box 3
Winnipeg, MB R3C 2G1
Canada

©2013 Bible for Children, Inc.

E drejta e kopjimit: Mund të bëni kopje ose ta shtypni këtë histori,
nëse nuk do ta shitni.







Kur Perëndia shpengoi Izraelitët jashtë nga Egjipti, Moisiu e drejtoi popullin në adhurim. Ai këndoi një këngë lavdërimi. "Unë do ti këndoj Perëndisë, sepse ai ka triumfuar me lavdi". Moisiu


këndoi për të gjitha gjërat e mëdha që Perëndia kishte bërë për Izraelin.

HALELUJJA! 
LAVDI PERËNDISË!





Pas tre ditësh në shkretëtirë
njerëzit e etur gjetën një oaz me
ujë. Por ata nuk e pinin dot ujin e
hidhur. Në vend që të luteshin,
njerëzit u ankuan.



Perëndia është shumë
i mirë. Ai e bëri ujin
të mirë, për tu pirë.





Dukej sikur njerëzit
ankoheshin për gjithçka.


"Ne kishim ushqim në Egjipt. Në
shkretëtirë ne do të vdesim nga uria", bërtitën
ata. Atë mbrëmje, Perëndia dërgoi disa zogj të
quajtur shkurta. Njerëzit i zinin ato me lehtësi.




Mëngjesin tjetër,
Perëndia dërgoi mana.
Ishte një lloj buke, që
kishte shijen si vaferat
me mjaltë.



Ata duhej ti besonin Perëndisë, çdo ditë për ushqimin e tyre të asaj dite. Por disa njerëz, mblodhën më shumë se ç'duhej dhe ajo u prish gjatë natës.



Dhe nuk donte mend, që mana e djeshme ishte plot me krimba - përveçse gjatë ditës së shtunë. Atë ditë njerëzit pushonin, dhe hanin manën e ditës së djeshme.




Perëndia u kujdes për
Izrealitët në shkretëtirë.
Ai u dha atyre ushqim
dhe ujë -dhe i mbrojti
ata nga armiqtë.




Kur Amalekitët sulmuan,
Izraeli fitonte betejën
për sa kohë Moisiu e
mbante lart shkopin
e Perëndisë.





Perëndia u tha Izrealitëve, "Nëse ju i bindeni zërit Tim, ju do të jeni njerëzit e Mi të veçantë." "Gjithçka që thotë Perëndia, ne do ta bëjmë", i thanë njerëzit Moisiut. Ata erdhën në këmbët e malit Sinai, ndërsa Moisiu shkoi të takojë Perëndinë.





Moisiu ishte
me Perëndinë
në mal për
dyzet ditë.
Perëndia
shkroi Dhjetë
Urdhërimet
në dy rrasa
prej guri. Ai i
tregoi Moisiut
mënyrën se si
Ai donte që
njerëzit e Tij
të jetonin.



1. Ti nuk do të kesh perëndi të tjerë përpara Meje.

2. Nuk do të bësh dhe as do të biesh përmbys përpara imazheve.

3. Mos e përdor, emrin e Zotit, Perëndisë tënd më kot.

4. Kujtoje ditën e shtunë, dhe mbaje atë të shenjtë.

5. Ndero babanë dhe nënën tënde.



6. Ti nuk do të vrasësh.


7. Nuk do të kryesh tradhëti bashkshortore.

8. Nuk do të vjedhësh.

9. Nuk do të gënjesh.

10. Nuk do të lakmosh.





Ndërsa Moisiu ishte me Perëndinë në malin Sinai, Izraelitët bënë diçka të tmerrshme. Ata urdhëruan Aronin të bëjë një viç të artë - dhe ata adhuruan viçin në vend të Perëndisë. Perëndia u zemërua shumë. Po kështu edhe Moisiu.





Kur Moisiu pa viçin dhe njerëzit që kërcenin, ai i përplasi përtokë dhe i bëri copash të dy rrasat e gurit. Moisiu me zemërim e shkatërroi idhullin e artë. Ai vrau njerëzit e ligj që e kishin adhuruar.



Perëndia zëvendësoi dy rrasat e gurit. Ai i tha Moisiut të ndërtonte një Tabernakull - një tendë të madhe me gardh rreth e qark - ku Perëndia të banonte në mes të njerëzve të Tij. Ata duhej ta adhuronin Perëndinë atje. Kollona e resë dhe e zjarrit, tregonte praninë e Perëndisë në mes të tyre.



Ndërsa ata iu afruan Kananit, Moisiu dërgoi dymbëdhjetë spiunë për të parë vendin që Perëndia u kishte premtuar njerëzve të Tij.



Spiunët ishin të gjithë të një mendjeje, se vendi ishte shumë i bukur! Por vetëm dy prej tyre, Jozueu dhe Kalebi, besuan se ata mund ta pushtonin vendin me ndihmën e Perëndisë.




Dhjetë spiunët e tjerë ishin të frikësuar nga qytet e mëdha dhe gjigandët në vend.

“Ne nuk mund ta marrim atë vend”, u qaravitën ata.

Ata, harruan gjërat e mëdha që Perëndia kishte bërë, për ti çliruar ata nga Egjipti.



Populli, ndoqi këta spiunët që nuk besonin. Ata filluan të qajnë, dhe u përgatitën të kthehen mbrapsht në Egjipt. Ata madje u përpoqën të vrasin edhe Moisiun!



Perëndia shpëtoi jetën e Moisiut. Pastaj Ai u tha njerëzve, "Për dyzet vjet ju do të endeni në shkretëtirë. Vetëm Kalebi, Jozueu dhe bijtë tuaj do të jetojnë për të hyrë në vendin që ju e përçmuat".



Dyzet Vjet

Një tregim nga Fjala e Perëndisë, Bibla


e marrë nga

Eksodi 15 deri tek Numrat 14

"Zbulimi i fjalëve të tua ndriçon dhe u
jep mendje njerëzve të thjeshtë."

Psalmet 119:130





12

60



Ky tregim nga Bibla na tregon për Perëndinë tonë të
mrekullueshëm i cili na krijoi dhe dëshiron që
ne ta njohim Atë.

Perëndia e di që ne kemi bërë gjëra të këqija, të cilat Ai i quan
mëkate. Dënimi për mëkatin është vdekja, por Perëndia ju do juve
aq shumë sa që dërgoi Birin e Tij të vetëm, Jezusin, që të vdesë në
Kryq dhe të dënohet për mëkatet tuaja. Pastaj Jezusi u ringjall
dhe u ngrit lart në Qiell! Nëse beson në Jezusin dhe i kërkon Atij
të t'i falë mëkatet e tua, Ai do ta bëjë atë! Ai do të vijë dhe do të
jetojë në ty, dhe ti do të jetosh me Të përgjithmonë.

Nëse ti beson se kjo është e vërteta, drejtoju Perëndisë kështu:
Jezus i dashur, unë besoj se Ti je Perëndia i bërë njeri për të
vdekur për mëkatet e mia, dhe që Ti u ngjalle sërish. Të lutem,
eja në jetën time dhe fali mëkatet e mia, në mënyrë që unë të kem
jetë të re dhe një ditë të jem me Ty, përgjithmonë. Më ndihmo,
të të bindem dhe jetoj për Ty, si fëmija Yt. Amen.

Lexo Biblën dhe bisedo me Perëndinë çdo ditë! Gjoni 3:16

